REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. ____ prot. Tiranë, më ___ . ___ . 2021

Lënda: **Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2021**

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2021, miratuar me vendimin nr. 04 prot, datë 26.05.2021, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përgatitur Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën janar - prill 2021, sipas kësaj shkrese dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për 4- mujorin e parë të vitit 2021, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2021-2023).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2021, Kolegji i Posaçëm të Apelimit ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 90 (nëntëdhjetë) çështje. Gjatë periudhës janar - prill 2021, Kolegji i Posaçëm të Apelimit ka marrë në shqyrtim 25 (njëzet e pesë) çështje.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit në zbatim të ligjit nr. 137, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021", për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, janë përcaktuar në vlerën ***157.15 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë pesëmbëdhjetë) milionë lekë***.

Plani i shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-prill 2021 është ***59.15 milionë lekë*** dhe realizimi në vlerën ***45.55 milionë lekë*** ose *77 %*. Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Llogaria ekonomike	Emertimi	Plani vjetor	Plani 4-mujor	Realizimi 4-mujor	% realizimit
6000000	Paga	115,700	43,700	39,375	90.1%
6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetsore	9,300	3,750	3,485	92.9%
6020000	Mallra dhe shërbime	22,900	5,450	2,550	46.8%
6060000	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,250	1,250	144	11.5%
2310000	Investime Kapitale	8,000	5,000	0	0.0%
	Totali	**157,150**	**59,150**	**45,554**	**77.0%**

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2021 në paga është ***115.7 milionë lekë*** dhe përbën 73.6 % të buxhetit total vjetor të miratuar me ligj për vitin 2021. Buxheti i detajuar në paga, për periudhën janar- prill 2021, është ***43.7 milionë*** lekë. Realizimi paraqitet në vlerën ***39.4 milionë*** lekë ose 90 % të planit 4/mujor dhe përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 49 (dyzet e nëntë) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 101, datë 04.10.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe pagat për 6 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar në VKM-në nr. 1151, datë 24.12.2020. Në realizimin e buxhetit të kësaj periudhe në zërin paga është përfshirë dhe pagesa me një pagë mujore, si vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, sipas vendimit nr. 27, datë 19.03.2021, të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Niveli i realizimit të këtij zëri të shpenzimeve është ndikuar dhe nga fakti që procedurat e rekrutimit për 6 (gjashtë) këshilltarët shtesë të Njësisë së Shërbimit Ligjor, nuk kanë përfunduar ende.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2021 në sigurime shoqërore është ***9.3 milionë lekë*** dhe përbën 5.9 % të buxhetit total vjetor 2021. Buxheti i detajuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar- prill 2021, është ***3.8 milionë*** lekë. Realizimi paraqitet në vlerën ***3.5 milionë lekë*** ose 93 % të planit 4/mujor. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihet një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2021, në shpenzime operative është ***24 milionë lekë*** dhe përbën 15.3% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2021. Buxheti i rishikuar, pas transferimit të fondit nga artikulli 602 ne artikullin 606, është ***22.9 milion lekë***.
Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për periudhën janar- prill 2021, është ***5.5 milionë*** lekë dhe realizimi ***2.6 milionë lekë*** ose 46.8 % të planit 4/mujor.

Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	**Realizimi viti 2021 (në lekë)**
Shpenzime për energji elektrike	**566.224**
Shpenzime për furnizimin me ujë	**17.482**
Shpenzime për kanceleri dhe letër	**400.381**
Shpenzime për materiale pastrimi dhe higjeno sanitare	**418.560**
Shpenzime për dezinfektimi e ambienteve për Covid-19	**100.368**
Shërbime telefonie	**71.293**
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	**50.495**
Karburant për automjetin dhe gjeneratorin	**180.720**
Shërbime transporti (parkim për automjetin e institucionit + lavash + mirëmbajtje)	**198.000**
Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur (shpenzime telefonie)	**138.297**
Shpenzime publikimi në shtyp për pozicionet vakante në institucion	**374.400**
Shpenzime te tjera	**33.780**
TOTALI	**2.550.000**

Gjatë periudhës janar - prill 2021, janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale dhe shërbime të nevojshme gjatë aktivitetit të përditshëm të institucionit ku përfshihen shpenzime për kancelari, letër A4, materiale pastrimi dhe shpenzimet që lidhen me masat e parandalimit të përhapjes së Covid-19, si: furnizime me maska, solucion dezinfektues, dezinfektim dhe ndarje e ambienteve të punës në zbatim të rregullores "Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", me vlerë totale 919.309 lekë.

Janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar) si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion, për një vlerë totale 1.008.441 lekë.

Janë kryer shpenzime për automjetin e institucionit duke përfshirë pastrimin, vend parkimin dhe furnizimin me karburant me vlerë totale 378.720 lekë.

Gjithashtu në realizimin e kësaj periudhe janë përfshirë shpenzime për materiale dhe shërbime të tjera të natyrave të ndryshme, për një vlerë totale 33.780 lekë.

Në buxhetin e detajuar për këtë periudhë është përfshirë edhe fondi për mirëmbajtjen e sistemeve të instaluara në godinë në vlerën 700 mijë. Realizimi i këtij procesi është i lidhur me nënshkrimin e akt marrëveshjes me Ministrinë e Drejtësisë për "kalimin (dhënien) në përdorim pa kundërshpërblim, në favor të KPA-së, të një pjese të godinës së Kuvendit të Shqipërisë (e rikonstruktuar)" që aktualisht nuk është kryer si pasojë e mos funksionimit të daljes së emergjencës në ambientet e Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimit në projektin e rikontruksionit**.** Është rënë dakort në parim me Gjykatën Kushtetuesen për zgjidhjen e kësaj çështje dhe jemi në pritje të finalizimit.

Gjithashtu është në proces procedura e prokurimit për mirëmbajtjen e e serverëve të institucionit në vlerën 400 mijë lekë, si kërkesë ligjore përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 21 gusht 2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit". Aktualisht në Kolegj janë të instaluar dy serverë HP, për transmetimin dhe ruajtjen e të dhënave.

IV - Shpenzimet për Trans per Buxh. Fam. & Individ (llogaria ekonomike 606)

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën ***1.25 milionë lekë*** dhe realizimi ***144 mijë lekë*** ose 11.5%.

Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerë 150 mijë lekë miratuar me ligjin nr. 137, datë 16.11.2020, " Për buxhetin e vitit 2021" si dhe fondi në vlerë 1,150 mijë lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për gjyqtarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 5923/1, datë 01.04.2021, nga artikulli 602 "Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime" ne artikullin 606.

Gjatë kësaj periudhe është kryer pagesa prej një page mujore, në vlerë 73,940 lekë, me rastin e daljes në pension të ish- punonjëses së protokoll- arkivit, sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, datë 17.11.2020 " Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar si dhe rimbursimi i shpenzimeve telefonike të gjyqtarëve sipas përcaktimit në VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publik, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

V. Investime kapitale (431)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2021 në investime është ***8 milionë lekë*** dhe përbën 5 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin investime, për periudhën janar- prill 2021, është ***5 milionë*** lekë dhe realizimi ***0 (zero)***lekë ose 0 %.

Këto fonde janë parashikuar për kompletimin me pajisje e poste pune për shtesat e kërkuara në strukturën organike të Kolegjit si dhe vënien në funksion të ambienteve në katin e parë të godinës ku vijon të ushtrojë veprimtarinë Shoqata e të Përndjekurve Antikomunistë të Shqipërisë.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 26.04.2018, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Kuvendit të Republikës", ambientet ku aktualisht vijon aktivitetin Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, kanë kaluar në administrim të Ministrisë së Drejtësisë për nevoja të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Institucionit të Komisionerit Publik. Deri në këtë moment nuk është bërë e mundur kalimi i këtyre ambjenteve me qëllim përshtatjen e tyre.

Për nevoja të institucionit, për pajisjen e personelit të ri shtesë me asetet e nevojshme të postit të punës, mobilje dhe pajisje elektronike, janë zhvilluar dhe janë në proces likuidimi procedurat e prokurimit, si më poshtë:

- Procedura e prokurimit e llojit Blerje me Vlerë të Vogël, me objekt: "Blerje pajisje dhe mobilje të ndryshme", për të cilën është lidhur kontrata më datë 09.03.2021, me operatorin ekonomik të shpallur fitues, Shoqërinë "SHAGA" sh.p.k (fondi prokuruar 867.080 lekë dhe vlera e kontratës së lidhur 792.000 lekë).
- Procedura e prokurimit e llojit "Kërkesë për Propozim-Mallra", me objekt: "Blerje pajisje kompjuterike/elektronike", e cila për periudhën raportuese ndodhej në fazën e njoftimit të operatorit ekonomik fitues "PC STORE" shpk, për lidhjen e kontratës (fondi prokuruar 2.700.000 lekë dhe vlera e kontratës së lidhur 2.038.500 lekë).

Duke ju falënderuar për vëmendjen,